




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA EKONOMISË, KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 413 .Prot

Elbasan më 17.05.2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarive të ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional", ne Urdherin nr.966/1, prot nr. 49, datë 12.02.2024, "Për miratimin e numrit të Instruktorëve dhe Mesuesve me kohe të pjesshme për vitin 2024"

Ofruesi publik i AFP-së Qendrës së Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet:

- Instruktor/e Manikyr-Pedikyr - 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave

penale

- d) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- e) Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punes ne grup dhe te motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Te kete diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem,ne profesionin e kursit te formimit profesional per te cilin po aplikon;
- b) Te kete te pakten 3 (tre) vjet pervoje pune ne fushen ,ne te cilen eshte kualifikuar;
- c) Te njohe dhe te perdore teknologjine e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjendjes shëndetësore
- vërtetimin të gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2.Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre.

Dokumentet ne gjuhen e huaj duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

3.Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin te ofrunit publik të AFP-së brenda dates 27.05.2024

DREJTOR

Krenar XHEMALI